

D E K R E T
Nr.1984, datë 7.1.1998

**PËR KRIJIMIN E GJYKATAVE TË APELIT DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TOKËSORE TË
VEPRIMTARISË SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe të nenit 1 të ligjit nr.8245, datë 24.9.1997, “Pë disa ndryshime në ligjin nr.7806, datë 17.3.1994 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7574, datë 24.6.1992 “Për Organizimin e Drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë,

D E K R E T O J:

Neni 1

Krijohen gjashtë Gjykata Apeli me kufijë territoriale të veprimtarisë së tyre si më poshtë:

1. Gjykata e Apelit Tiranë, me qendër në Tiranë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Tiranë, Krujë, Kurbin, Mat, Mirditë, Bulqizë dhe Dibër.
2. Gjykata e Apelit Durrës, me qendër në Durrës, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Durrës, Kavajë, Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin.
3. Gjykata e Apelit Shkodër, me qendër në Shkodër, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Shkodër, Lezhë, Malësi e Madhe, Pukë, Tropojë, Kukës dhe Has.
4. Gjykata e Apelit Vlorë, me qendër në Vlorë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Fier, Vlorë, Mallakastër, Lushnje, Berat, Skrapar dhe Kuçovë.
5. Gjykata e Apelit Korçë, me qendër në Korçë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Korçë, Pogradec, Kolonjë dhe Devoll.
6. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me qendër në Gjirokastrë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë, Tepelenë dhe Përmet.

Neni 2

Fillimi i funksionimit të punës të secilës Gjykatë Apeli do të bëhet pas 10 ditëve të emërimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë të gjyqtarëve të tyre.

Deri ditën e fillimit të funksionimit nga puna të secilës Gjykatë Apeli, ankimet ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë do të vazhdojnë të shqyrtohen nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani